

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU
--	---	---

6 shkurt 2013

SCC – 11 – 0265

1. N.S., XX
2. M.S., XX
3. E.S., XX
4. B.S., XX

Të gjithë përfaqësohen nga XX, avokat nga XX

Paditës

Kundër

1. **KB XX, XX**, Përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr.Illir Konushevci, Nr. 8, Prishtinë
2. **Komuna e XX, XX**

Të paditura

Kolegji i parë i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit i përbërë nga Gjyqtari kryesues Alfred Graf von Keyserlingk, Gjyqtari Shkelzen Sylaj dhe Gjyqtari Qerim Fazliji, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 6 shkurt 2013 lëshon këtë

AKTGJYKIM

Padia hidhet poshtë si e pabazuar

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 6 qershor 2007, Paditësit si pasardhësit e A.M.S. dhe B.S. kanë paraqitur në Gjykatën Komunale të XX një padi në të cilën kërkojnë që të njihen si pronarët e disa ngastrave kadastrale të regjistruara në Listën poseduese 166, Zona Kadastrale Bellanicë. Paditësit deklarojnë se pasardhësit e tyre i ishin nënshtruar presionit fizik dhe politik gjë që ka rezultuar në shtetëzimin (nacionalizimin) e pronës së tyre. Prona aktualisht është e regjistruar në emër të të paditurës së parë, në kuadër të ngastrës kadastrale P-72316002-00024-0, Lista poseduese 124, Zona Kadastrale Bellanicë. Paditësit deklarojnë se prona është shtetëzuar pa asnjë bazë ligjore në periudhën 1959-1967 në bazë të vendimeve të 27 prillit 1959 dhe 28 prillit 1959 nga Komisioni i

Komunës së Banjës. Ata janë duke e shfrytëzuar pronën që nga viti 1990 sepse e paditura e Parë e kishte braktisur atë.

Më 21 prill 2011 Gjykata Komunale Malishevë ka vendosur se kjo çështje nuk është në kompetencën e tij dhe e ka përcjellë dosjen e çështjes në Dhomën e Posaçme.

Më 23 nëntor 2011 Dhoma e Posaçme ka vendosur se padia kundër të paditurës së parë bie në kuadër të juridiksionit parësor të Dhomës së Posaçme dhe se bartet për gjykim nga Gjykata Komunale në Dhomën e Posaçme, ndërsa për gjykimin e plotë dhe komplet të çështjes padia kundër të paditurës së dytë do të vendoset në të njëjtin proces gjyqësor.

Në mbrojtjen e 19 qershorit 2012 Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) në emër të të paditurës së parë ka deklaruar se padia duhet të hidhet poshtë si e pabazuar. AKP-ja deklaroi se paditësit nuk kanë paraqitur vendimin e trashëgimisë për të dëshmuar se janë trashëgimtarë ligjorë me të drejtë që ta parashtronë këtë padi. AKP-ja e kontestoi se prona është shpronësuar në mënyrë të paligjshme. AKP-ja deklaroi se çfarëdo mangësie në transaksion (shitblerje) duhet të ishte kundërshtuar në përputhje me Nenet 111 dhe 117 të Ligjit për Detyrimet, që parasheh periudhën maksimale prej 5 vjetësh për anulim. Në bazë të këtyre më lart, AKP-ja argumentoi se padia është e parashkruar (e vjetruar) dhe në alternativë e pabazuar.

Me urdher të Kolegjit të 8 gushtit 2012 AKP-së i është kërkuar të dorëzojë autorizimin që emëron një avokat i cili është anëtar i një shoqate të avokatëve apo odës së Avokatëve për të përfaqësuar atë para Dhomës së Posaçme.

Në seancën dëgjimore të 21 nëntorit 2012 AKP-ja është paraqitur pa avokat të regjistruar, edhe pse kjo ishte paralajmëruar me urdhrin e gjykatës datë 8 gusht 2012 se ajo duhet të përfaqësohet nga një avokat i regjistruar.

Arsyetimi ligjor

1.

Pretendimet e dy të paditurave nuk merren parasysh sepse nuk janë paraqitur nga avokati.

Para Dhomës së Posaçme secila palë, përveç personave fizikë, duhet të përfaqësohet nga një avokat (Shtojca Neni 24 LDHP 04/L-033). Kjo vlen edhe për NSH-të që përfaqësohen nga AKP-ja. Formulimit të kësaj dispozite i mungon ndonjë indikacion në lidhje me arsyen pse nuk duhet të vlejë kjo. Nenet 73, 74, 85 dhe 86 të Kodit të Procedurës Kontestimore (Ligji Nr.03/L-006, KPK) që parasheh se kush mund të jetë palë, çfarë veprimesh mund të ndërmarrë pala dhe kush mund ta përfaqësojë një palë lejon që palët dhe përfaqësuesit të cilët nuk janë avokatë të regjistruar të veprojnë në gjykatë, por në raport me këto dispozita, Neni 24 i Shtojcës së LDHP-së është Lex

Posterior dhe Lex Specialis. Ligjvënësi e ka nxjerrë Nenin 24 të Shtojcës së LDHP-së ndërkohë që KPK tashmë ekzistonte dhe me Nenin 24 të Shtojcës së LDHP-së ka paraparë një procedurë të veçantë në një gjykatë të veçantë, të ndryshme nga gjykatat e tjera të Kosovës. Neni 24 i Shtojcës së LDHP-së zëvendëson edhe Nenin 29 të Ligjit për AKP-në (04/L-034, LAKP), sepse është nxjerrë më vonë dhe nuk e rregullon përfaqësimin në përgjithësi, siç bën LAKP por në veçanti përfaqësimin para DHPGJS-së. Kjo vlen edhe për Nenin 29.2 të LAKP-së i cili rregullon “pozicionin ligjor” të Agjencisë për të ndjekur të drejtat e një ndërmarrjeje në gjykatë kompetente në emër të ndërmarrjes në fjalë.

Rregullimi ligjor sa i përket asaj që personat fizikë nuk kanë nevojë për avokat, por gjithë të tjerët kanë nevojë për avokat nuk shkel Nenin 73 dhe 74 të KPK-së. Kjo nuk është e mundur sepse Nenet 73 dhe 74 nuk vlejnë këtu. Ato zëvendësohen nga Neni 24 i Shtojcës së LDHP-së.

Kriteri për përfaqësim nga një avokat nuk është shkelje e të drejtës kushtetuese të barazisë para ligjit. Mbetet çështje e hapur nëse AKP-ja si "organ publik" (Neni 1.1 LAKP) mund të argumentojë (të mbrohet) në lidhje me të drejtën themelore të barazisë, që është historikisht dhe në kontekstin e saj kushtetues e drejtë e personave fizikë dhe subjekteve private juridike kundër shtetit, jo e drejtë e një organi shtetëror kundër shtetit. E paditura ka të drejtë të trajtohet në mënyrë të barabartë, por barazia kushtetuese nuk do të thotë se të gjithë trajtohen njësoj, pavarësisht nëse ekzistojnë aspekte të arsyeshme dhe jo-diskriminuese të diferencimit. Nuk është as e paarsyeshme dhe as diskriminuese që të privilegjojnë personat fizikë para gjykatës në raport me personat juridikë (ose një autoritet shtetëror publik). Shpesh, nëse jo madje edhe rregullisht personat fizikë nuk kanë mjete financiare për të përballuar avokatin. Kjo në kuadër të aspekteve kushtetuese është arsye e mjaftueshme për privilegjin e tyre për t'u paraqitur para DHPGJS-së pa avokat.

Rrjedhimisht mund të thuhet se të paditurat, si çdokush, përveç personave fizikë, duhet të përfaqësohen para Dhomës së Posaçme nga një avokat i cili është anëtar i shoqatës së avokatëve ose odës së avokatëve. Meqë dy të paditurat nuk janë përfaqësuar nga një avokat i regjistruar, duhet të konsiderohen se nuk janë paraqitur në gjykatë.

2.

Megjithatë kundër të paditurave nuk mund të jepet aktgjykim në mungesë (Neni 52.2 i Shtojcës së LDHP-së). Faktet e paraqitura nga paditësit nuk e mbështesin përfundimisht padinë. Padia është e pabazuar.

Dy vendimet e kundërshtuara të datës 27 prill 1959 dhe 28 prill 1959 (të dorëzuara në Dhomën e Posaçme vetëm në seancën dëgjimore të 21 nëntorit 2012) janë nxjerrë nga Komiteti Popullor i Rrethit të Prizrenit në bazë të Ligjit për autoritetet dhe Procedurës për rregullimin e uzurpimit të pronës publike dhe Ligjit për reformën agrare dhe

kolonizimin (DFJ GZ 64/1945). Komiteti popullor ka vendosur se një tokë e zënë nga B.B. (raporti me paditësit i pasqaruar) është pronë publike dhe për këtë arsye ai nuk ka asnjë të drejtë pronësore mbi atë pronë. Paditësit argumentojnë se paraardhësit e tyre nuk janë “pajtuar” me shtetëzimin e pronës së tyre. Ky argument nuk mund të ndiqet, sepse prona është shpallur pronë publike me dy vendimet e komunës dhe jo me kontratë.

Këto dy vendime ishin bërë të formës së prerë. Sipas këshillës së tyre ligjore ato do të mund të ishin apeluar brenda 15 ditëve. B.B. nuk ka apeluar. Kolegji ka konsideruar pretendimin e paditësit në lidhje me atë se B.B. në këto vendime është definuar gabimisht si uzurpues, se ai është ndjerë i kërcënuar dhe nën presion psikologjik dhe se e ka konsideruar padinë kundër këtyre vendimeve si të padobishme.

Ai mund të jetë frikësuar për disavantazhet dhe mund të mos ketë pritur që do të kishte sukses në apel, por në pretendimin (pohimin) e paditësit nuk është argumentuar përfundimisht në mënyrë të mjaftueshme se kjo frikë ka qenë objektivisht e justifikuar dhe se ka qenë në një shkallë ajo që e ka detyruar dhe që e ka bërë atë të paaftë për të pasur dhe ushtruar vullnetin e tij. Prandaj vendimet e komunës mbeten të formës së prerë.

Padia është e pabazuar.

Shpenzimet

Gjykata nuk cakton shpenzimet për paditësin meqë Presidiumi i Gjykatës deri më tani nuk e ka nxjerrë planin me shkrim i cili miratohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Neni 57 Paragrafi 2 i Ligjit të Dhomës së Posaçme). Kjo do të thotë se deri tani nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për shqiptimin e shpenzimeve.

Këshilla ligjore

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet Apel brenda 21 ditësh tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme. Apeli duhet t'i dërgohet edhe palës tjetër dhe të dorëzohet tek Kolegji Gjykues nga Ankuesi brenda 21 ditësh. Ankuesi duhet të dorëzojë tek Kolegji i Apelit dëshminë se e ka dërguar Apelin edhe tek pala tjetër.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur Ankuesit i është dërguar aktvendimi me shkrim.

Kolegji i Apelit e refuzon apelin si të papranueshëm nëse Ankuesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.

E paditura mund të parashtrrojë përgjigje tek Kolegji i Apelit brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar apeli, duke e dorëzuar përgjigjen edhe tek ankuesi dhe tek pala tjetër.

Ankuesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në apelin e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e vet tek Kolegji i Apelit dhe për ta dërguar atë tek pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e ankuesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek Ankuesi dhe tek Kolegji i Apelit.

Alfred Graf von Keyserlingk,
Gjyqtar kryesues

[nënshkruar]

Urdhër i brendshëm

Ky aktvendim duhet t'u dërgohet palëve (përkatësisht avokatëve të tyre)